

RE. KO. DR. 01-1045  
REPUBLICA E KOSOVES  
KOMUNA E PRISHTINES



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-94732/21 dt. 27.05.2021, të pronareve Sabri Curri, Shkëlqim Çollaku, Fitnete Jashari dhe Adem Potera nga Prishtina, dhe investitorit “Art Construction 10” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Faton Sinani nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urban “C9”, të tërësisë “C”, të Planit Rregullues “Mati I” në rr. “Xhafer Shala”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, në procedurë administrative, me datë 13.07.2021, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** Sabri Curri, Shkëlqim Çollaku, Fitnete Jashari dhe Adem Potera nga Prishtina, dhe investitorit “Art Construction 10” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Faton Sinani nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-94732/21 dt. 27.05.2021, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet B+P+6 e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-95447/19 dt. 16.08.2019, në parcelën kadastrale nr. 1645-1 (produkt i bashkimit të parcelave kadastrale me nr. 809-10, 809-12, 809-29 dhe 809-30), e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-1645-1, ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urban “C9”, të tërësisë “C”, të Planit Rregullues “Mati I” dhe Planit Zhvillimore Urban në Prishtinë.

**II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Xhafer Shala” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 49 dhe 53 në Prishtinë, dhe e njejta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Pronareve Sabri Curri, Shkëlqim Çollaku, Fitnete Jashari dhe Adem Potera nga Prishtina, me investitor “Art Construction 10” sh.p.k., me seli në Prishtinë, dhe me përfaqësues Faton Sinani nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-94732/21 dt. 27.05.2021, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste & banesore, me etazhitet B+P+6 e ndërtuar në kuadër të bllokut urban “C9”, të tërësisë “C”, të Planit Rregullues “Mati I” dhe Planit Zhvillimore Urban në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1645-1 (produkt i bashkimit të parcelave kadastrale me nr. 809-10, 809-12, 809-29 dhe 809-30), ZK Matiçan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-95447/19 dt. 16.08.2019, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Drejtorinë e Urbanizimit; Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 6 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Sevdat Bektashi/ Samire Hyseni; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Sami Idrizi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Astrit Salihu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Kushtrim Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Gazmend Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Naser Berisha; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Burim Halilaj me nr. të licensës 195;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

**I dorëzohet:** Kërkuessit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,**  
**05 NR. 391/02-94732/21 DT. 13.07.2021**

Zyrtarja,  
Bahtije Villasaliu

*B. Villasaliu*

U.D. Udhëheqëse e Sektorit,  
Mimoza Berisha Prestreshi

*M. Berisha Prestreshi*

Drejtori,  
Ardian Olluri



